



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 03.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.10.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **NNP C.T.A. shpk rr. MEHMET GRADICA HY2 NR6, PRISHTINE**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i kulmit të dëmtuar në shkollën Ernest Koliqi në Babush i Muhaxherëve” me Nr. të Prok: 613-23-9690-5-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **NNP C.T.A. shpk rr. MEHMET GRADICA HY2 NR6, PRISHTINE** të dt. 02.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i kulmit të dëmtuar në shkollën Ernest Koliqi në Babush i Muhaxherëve” me Nr. të Prok: 613-23-9690-5-2-1 si e jastë afatshme

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërbllim me kontratë për Operatorin Ekonomik “**TALA ENGINEERING**” SH.P.K” shpk nga Suharekë. i publikuar me datë: 27.09.2023

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **NP C.T.A. shpk rr. MEHMET GRADICA HY2 NR6, PRISHTINE** me datë. 02.10.2023ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i kulmit të dëmtuar në shkollën Ernest Koliqi në Babush i Muhaxherëve” me Nr. të Prok: 613-23-9690-5-2-1”. **për këtë** aktivitet të prokurimit AK ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik “**TALA ENGINEERING**” SH.P.K” shpk nga Suharek, më të datës 27.09.2023 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Në bazë të “Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave”, neni 4 pika b në të cilin thuhet: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit

Dhë në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 5 për kalkulimin e afateve kohore pika 1 dhe 2 në të cilët thuhet:

Pika 1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Pika 2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj


Në bazë të këtyre rregullave dhe Ligjit të prokurimit publik ju keni paraqitur kërkesë për rishqyrtim jashtë afatit ligjor, përkatësisht këtë kërkesë për rishqyrtim e keni paraqitur në ditën e 5 mbas orës 16:00 apo më saktë në ora 19:51 dhe si e tillë kërkesa për rishqyrtim hudhet poshtë.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

për Bekim Shabani


Drejtor i Prokurimit